



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1994 Prot.

Tiranë, 8.7 2020

Lënda: Mbi procesin zgjedhor në Universitetin e Tiranës.

**Drejtuar: Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Znj. Besa Shahini**

**Për dijëni: Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Sh.T.Z. Ilir Meta**
(lutemi referojuni shkresës nr.1621 datë 13.05.2020 të Rektorit të UT)

**Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë
Z. Edi Rama**
(lutemi referojuni shkresës nr.1623 datë 14.05.2020 të Rektorit të UT)

E nderuara zonja Ministre,

Në vijim të shkresës nr.1624 datë 14.05.2020 (bashkëngjitur) "*Përcillet informacion mbi procesin zgjedhor për autoritetet dhe anëtarët e Senatit Akademik të UT*", dhe të shkresës nr.1924/12 datë 03.07.2020 (bashkëngjitur edhe praktika) "*Informacion mbi ecurinë deri tani të procesit zgjedhor në Universitetin e Tiranës*", në cilësinë e Rektorit të UT dhe të detyrimeve ligjore që kam si autoriteti më i lartë drejtues në institucion, në lidhje me procesin zgjedhor që do të zhvillohet në Universitetin e Tiranës, për zgjedhjen e autoriteteve të reja drejtuese dhe të anëtarëve të Senatit Akademik të UT, meqënëse, edhe pas përfundimit të shtyrjes të afatit të dytë të aplikimeve (datë 3-4 korrik 2020), për anëtarë të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) të UT (neni 6 i Rregullores së Zgjedhjeve të UT) dhe për anëtarë të Komisionit të Apelimit (KA) të UT (neni 37 i Rregullores së Zgjedhjeve të UT), situata mbeti e njëjtë, sikurse e kam cituar edhe në shkresën time të fundit nr.1924/12 datë 03.07.2020, ju informoj se përsëri, situata me aplikimet për këto dy komisione, mbeti e njëjtë dhe mbledhja e Senatit Akademik i UT, e caktuar për t'u zhvilluar ditën e hënë, datë 6 korrik 2020, për arsye të mungesës së aplikimeve të kandidatëve për anëtarë të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) të UT, nuk u zhvillua.

Në datën 5 korrik 2020 (në përfundim të shtyrjes së afatit të dytë të aplikimeve) nëpërmjet email-it, kam bërë me dije të gjithë anëtarët e Senatit Akademik të UT (bashkëngjitur), mbi numrin e aplikimeve për të dyja komisionet; i kam njoftuar mbi hapjen edhe një herë të procesit të vetkandidimit për anëtarë të KIZ dhe të KA, në datat 6-7 korrik 2020, si dhe kam njoftuar anulimin e mbledhjes së SA në datën 6 korrik 2020, për t'i njoftuar në ditët në vijim për zhvillimin e një mbledhjeje tjetër të SA.

Nëpërmjet email-it, po në datën 5 korrik 2020 (bashkëngjitur), i jam drejtuar edhe drejtuesve të njësisve kryesore të Universitetit të Tiranës, duke i bërë me dije për situatën konkrete të aplikimeve për anëtarë të KIZ dhe të KA të UT, dhe i kam kërkuar që të merrnin të gjitha masat, në veçanti drejtuesit e njësisve kryesore, ku personeli akademik i fakulteteve që ata drejtonin, nuk kishte asnjë aplikim, me qëllim aplikimin e tyre, për të formatuar KIZ e UT, sipas përcaktimeve të nenin 6, pika 1/a të Rregullores së Zgjedhjeve të UT, në të cilën është përcaktuar se: “...**Përfaqësimi dhe numri i anëtarëve të KIZ, përcaktohet mbi bazën e numrit të njësisve kryesore të UT....**”.

Në datën 6 korrik 2020, nëpërmjet email-it (bashkëngjitur), i jam drejtuar edhe të gjithë personelit akademik me kohë të plotë të UT, nëpërmjet të cilit, i kam njoftuar mbi shtyrjen edhe një herë të afatit të vetkandidimit për anëtarë të KIZ dhe KA të UT, në datat 6-7 korrik 2020.

Fatkeqësisht, edhe në përfundim të afatit të fundit të aplikimeve (theksoj se aplikimet janë hapur tri herë, me qëllim mundësimin e krijimit të KIZ dhe KA të UT, si strukturat e vetme përgjegjëse për të administruar procesin zgjedhor në UT, sipas Rregullores së Zgjedhjeve të UT), përsëri situata mbeti e njëjtë, dhe nga (tre) njësitë kryesore të UT, konkretisht: **nga Fakulteti i Ekonomisë, nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, nuk pati asnjë aplikim apo vetkandidim për anëtarë të KIZ të UT.**

Gjithashtu, **nuk pati asnjë aplikim nga personeli i UT, as për sekretar i KIZ të UT, si anëtar i KIZ, pa të drejtë vote**, të përcaktuar në nenin 6, pika 1/a të Rregullores së Zgjedhjeve të UT.

Në këto kushte, në mungesë të aplikimeve për anëtarë të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) të UT, nuk e thërrita mbledhjen e Senatit Akademik të UT, pasi axhenda e kësaj mbledhjeje ishte vetëm votimi dhe më pas miratimi nga Senati Akademik i KIZ dhe KA i UT, si detyrë dhe përgjegjësi e Senatit Akademik të UT (neni 6, 37 i Rregullores së Zgjedhjeve të UT).

Sigurisht, ky proces aplikimi nuk mund të hapet përsëri, sepse, duke patur parasysh të gjitha procedurat që duhet të kryhen gjatë një procesi zgjedhor dhe afatet kohore për çdo procedurë, të përcaktuara shumë qartë në Rregulloren e Zgjedhjeve të UT, nuk mund ta finalizosh të gjithë këtë proces zgjedhor, në datën 30 korrik 2020, si data e zgjedhjeve për autoritete dhe organe drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë, të përcaktuar në Urdhërin nr.175 datë 30.06.2020 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “*Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë*” dhe më pas, në Urdhërin nr.6 datë 30.06.2020 të Rektorit të UT “*Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe Senatit Akademik të UT*” (bashkëngjitur).

Duhet kuptuar dhe sqaruar njëkohësisht, se Komisioni i Apelimit i UT (për këtë komision kishin aplikuar 7 kandidatë nga personeli akademik i njësisve kryesore të UT), sipas përcaktimeve të nenit 37, pika 8 e Rregullores së Zgjedhjeve të UT, “.....**shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen edhe mendimet “kundër”, për çdo ankim për vendime të marra prej KIZ-it**”, nuk mund të formatohet dhe të miratohet, pa u miratuar Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të UT, sepse një gjë e tillë, nuk do të kishte asnjë vlerë dhe asnjë kuptim ligjor.

Kjo do të thotë që Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) i UT, është e vetmja strukturë që ka përgjegjësi për administrimin e procesit zgjedhor në UT.

5(pesë) ish- personeli akademik i UT, të cilëve, sikurse jeni njoftuar dhe sqaruar edhe me shkresat e mëparshme, u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me UT që në datën 6 maj 2020, vazhdojnë të ndërmarrin veprime dhe të nxjerrin akte në funksion të procesit zgjedhor të UT. Provë për këtë, është Vendimi nr.13 datë 01.07.2020 (bashkëngjitur), për të cilin, sapo u vura në dijeni, me shkresën nr.1943 datë 01.07.2020 (bashkëngjitur), sqarova të gjithë personelin akademik të UT mbi paligjshmërinë dhe pavlefshmërinë e këtij vendimi; apo edhe Vendimi nr.14 datë 05.07.2020 i të ashtuquajturit KIZ (bashkëngjitur).

Këta ish-personel i UT, mbështeten hapur nga të gjithë drejtuesit e njësive kryesore (dekanët e fakulteteve) të UT, në veçanti nga z.Dh.Kule dhe z.A.Hoxha, për të cilët, kam bërë edhe kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë,

Të gjithë këta persona, kanë krijuar një konfuzion dhe një kaos total në institucion dhe në rradhët e personelit akademik të UT, siç duket edhe nga fakti i mungesës së aplikimeve apo vetkandidimeve nga ana e tyre, për anëtarë të KIZ dhe KA të UT.

Pikërisht ky kaos dhe ky konfuzion, ka prodhuar edhe këtë situatë paligjshmërie në procesin zgjedhor në UT.

Për këtë arsye, me shkresën nr. 1986 datë 08.07.2020 (bashkëngjitur), i kam kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të hetojë këtë situatë paligjshmërie të procesit zgjedhor në Universitetin e Tiranës.

E nderuara zonja Ministre,

Për të gjitha sa më sipër, duke patur parasysh edhe informacionin që ju kam përcjellë me shkresën nr.1924/12 datë 03.07.2020, sikurse e kam theksuar edhe në këtë shkresë, në mënyrë të menjëhershme, sapo nga Sekretari i Përgjithshëm i MASR, u përcoll në email, Urdhëri nr.175 datë 30.06.2020 i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “*Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë*”, në përmbushje të detyrimeve si autoriteti më i lartë drejtues i UT, në zbatim të nenit 5, pika 3 të Rregullores “*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës*”, të miratuar me Vendimin nr.5 datë 10.02.2020 të Senatit Akademik, nxorra Urdhërin nr.6 datë 30.06.2020 “*Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe Senatit Akademik të UT*”.

Në cilësinë e Rektorit të UT, kam zbatuar me përpikmëri maksimale çdo detyrim dhe përgjegjësi, shpeshherë edhe jo të parashikuara në Rregulloren e Zgjedhjeve të UT, siç ishte shtyrja e afateve të aplikimeve për kandidatë për anëtarë të KIZ dhe të KA të UT, duke njoftuar me të gjitha mënyrat dhe format zyrtare (edhe nëpërmjet rrjeteve sociale fb), vetëm me qëllim miratimin e KIZ dhe KA të UT, si struktura përgjegjëse të administrimit të një procesi zgjedhor të ligjshëm për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe Senatit Akademik të UT, **aktualisht, në Universitetin e Tiranës, nuk është miratuar Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ), sipas kërkesave të nenit 6 të Rregullores së Zgjedhjeve të UT.**

Kjo do të thotë që **në datën 30 korrik 2020, në Universitetin e Tiranës, nuk mund të zhvillohen zgjedhjet për autoritetet drejtuese dhe për anëtarë të Senatit Akademik të UT, në kushtet e pamundësisë të Senatit Akademik për të miratuar KIZ, dhe të kaosit dhe konfuzionit të shkaktuar nga 5(pesë) ish-personeli akademik i UT.**

Në zbatim të nenit 7, pika 2/e, j, të ligjit të arsimit të lartë 80/2015, si institucioni që duhet të kontrollojë pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucionit të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në tërësi, si dhe ligjshmërinë e zhvillimit të zgjedhjeve, i kërkoj me forcë Ministrinë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të vlerësojë informacionin dhe dokumentacion që ju kam përcjellë në lidhje me procesin zgjedhor në Universitetin e Tiranës, që të bëjë verifikimet e nevojshme për të gjitha sa ju kam informuar dhe sqaruar.

Është detyrim ligjor, por edhe moral i MASR, që Universiteti i Tiranës, si institucioni më i madh dhe më i rëndësishëm i arsimit të lartë në vend, të jetë modeli i zbatimit të ligjit dhe i asaj çfarë duhet të ndodhë në fakt edhe në IAL-të e tjera.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetem i hapur për çdo sqarim tjetër në lidhje me këtë çështje sa të rëndësishme, por edhe kaq delikate për Universitetin e Tiranës.

REKTORI

